



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI

Nr. 1216/2 Prot.

Pogradec, më 23. 03. 2021

VENDIM

Nr. 28, Datë 19. 03 2021

**"PER MIRATIMIN E KËRKESËS SË PERSONAVE QË DO TË VAZHDOJNË PROCEDURËN E PRIVATIZIMIT TË BANESAVE SHTETËRORE QË KANË MBETUR TË PAPRIVATIZUARA"**

Mbështetur në Ligjin Nr.22/2018 "Për Strehimin Social", gjithashtu dhe në zbatim të VKM Nr.179, datë 26.02.2020 "Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave që kanë qënë subjekt i ligjit Nr.7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", dhe të Ligjit Nr.9321, datë 25.11.2004, "Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyer në banesa, të ndërtuara me fondet e shoqërive dhe të ndërrmarjeve shtetërore", dispozitat e të cilit përcaktojnë procedurën e privatizimit të banesave që kanë mbetur të paprivatizuara, dhe VKM NR.898 , datë 18.11.2020 "RREGULLAT , KUSHTET , KRITERET E PROCEDURAT E PRIVATIZIMIT TË BANESAVE DHE OBJEKTEVE TË KTHYERA NË FOND BANESE TË PAPRIVATIZUARA", me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Keshilli i Bashkisë:

VENDOSI :

1. Të miratojë kërkesën e familjeve të mëposhtme për vazhdimin e procedurës së privatizimit të banesave që kanë mbetur të paprivatizuara:

Nr	Emri Mbiemri	Adresa	Dokumentacioni për plotësim	Procedura e privatizimit
1	Familja e z. Fiqiri Mulla	Rr."Rreshit Çollaku", Pallati 143,Shkalla 1, Ap.10	Formular 1, 2, 3, Kontratë Shitblerje	Vazhdim procedure privatizimi

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Strehimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas lajmërimit nga zyra përkatëse.

**SEKRETARI I KËSHILLIT**  
**Jona BOJKO**



**KRYETARI I KËSHILLIT**  
**Sotirag MANGËRI**

